



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave dhe Inspektimit

TREGUESIT STATISTIKOR TË SHËRBIMEVE POSTARE

Tremujori I 2025

Përmbajtje

I. HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME.....	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE	5
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare.....	5
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare.....	8
3. Treguesit e e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare.....	9
4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë	11
5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë.....	11

I . HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për tremujorin e parë të vitit 2025, si edhe krahasimet me tremujorin e parë të vitit 2024, i cili publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al, në seksionin “Statistika rreth AKEP” - “Shërbimet Postare”.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e parë të vitit 2025 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP për periudhën e raportimit janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (23 subjekte):**
 1. ADEX sh.p.k
 2. Albanian Delivery Express sh.p.k.
 3. ALOPOST sh.p.k.
 4. Air Cargo Service sh.p.k. (A.C.S.)
 5. BIPEX sh.p.k.
 6. DHL International (Albania) sh.p.k.
 7. Elite Post sh.p.k.
 8. EXPRESS ALB 24 sh.p.k.
 9. GED sh.p.k. (ish B.E.D. sh.p.k.)
 10. Greenposta shpk
 11. INTEX COURIER sh.p.k.
 12. IPOST sh.p.k.
 13. Milsped Albania sh.p.k.
 14. Mr. COURIER sh.p.k.

15. POSTA JONË sh.p.k.
16. POSTMAN sh.p.k.
17. T.N.T Express Albania sh.p.k.
18. Top Post sh.p.k.
19. Ultra C.E.P. sh.p.k.
20. Ulysses Enterprises sh.p.k.(Fedex)
21. United Transport sh.p.k. (Uni Trans)
22. Youth Albania Professional Services (YAPS)
23. GENIKI TAXYDROMIKI ALB sh.p.k.

Gjatë periudhës, nga tremujori i katërt i vitit 2024 deri në tremujorin e parë të vitit 2025 ka pasur një subjekt ALOPOST sh.p.k. të çregjistruar në AKEP më 08.04.2025 për ofrimin e shërbimeve postare. Tre subjekte përkatësisht ALOPOST sh.p.k.; GENIKI TAXYDROMIKI ALB sh.p.k. dhe IPOST sh.p.k. nuk kanë raportuar të dhënat statistikore për tremujorin e parë të vitit 2025. Të dhëna statistikore për tremujorin e parë të vitit 2025 për ofrimin e shërbimeve postare kanë raportuar 20 subjekte¹.

Posta Shqiptare me VKD Nr.13, datë 30.06.2020 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

¹ Ofrues të shërbimeve postare që kanë raportuar të dhënat statistikore në AKEP deri më datë 20.07.2025

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara nga ofruesit e shërbimeve postare përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare;
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres.

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 rezultojnë 5,582,656 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të dhëna në mënyrë më të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 1.1: Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara

Shërbime postare të ofruara	T1_2023	T2_2023	T3_2023	T4_2023	T1_2024	T2_2024	T3_2024	T4_2024	T1_2025	Ndryshim T1_2025/ T1_2024	Ndryshim T1_2025/ T1_2024
Posta Shqiptare sh.a											
1 Shërbim Universal Postar											
1.1 Postë brenda vendit	5,351,099	3,679,866	4,098,479	4,522,704	4,727,732	4,942,119	4,844,980	3,797,950	3,611,633	-5%	-24%
1.2 Postë ndërkombëtare	184,390	188,482	186,888	183,248	158,687	369,800	228,640	220,804	172,428	-22%	9%
1.3 Totali 1.1+1.2	5,535,489	3,868,348	4,285,367	4,705,952	4,886,419	5,311,919	5,073,620	4,018,754	3,784,061	-6%	-23%
2 Shërbim jouniversal postar											
2.1 Postë brenda vendit	92,252	164,019	72,173	73,570	86,517	57,479	134,400	88,127	82,661	-6%	-4%
2.2 Postë ndërkombëtare	146	631	532	574	233	55	20	35	313	794%	34%
2.3 Totali 2.1+2.2	92,398	164,650	72,705	74,144	86,750	57,534	134,420	88,162	82,974	-6%	-4%
3 Shërbim ekspres											
3.1 Ekspres brenda vendit	126,129	126,802	129,033	109,818	117,001	113,575	116,750	126,695	129,139	2%	10%
3.2 Ekspres ndërkombëtar	3,883	3,954	1,329	3,234	3,005	3,667	3,741	5,149	5,139	0%	71%
3.3 Totali 3.1+3.2	130,012	130,756	130,362	113,052	120,006	117,242	120,491	131,844	134,278	2%	12%
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare											
4 Shërbim JoUniversal Postar											
4.1 Postë brenda vendit	196,289	199,271	153,457	154,541	90,551	190,982	207,415	271,470	134,372	-51%	48%
4.2 Postë ndërkombëtare	2,819	4,295	4,304	23,192	1,764	1,956	1,471	2,215	1,507	-32%	-15%
4.3 Totali 4.1+4.2	199,108	203,566	157,761	177,733	92,315	192,938	208,886	273,685	135,879	-50%	47%
5 Shërbim ekspres											
5.1 Ekspres brenda vendit	712,332	679,269	689,710	825,031	825,844	833,005	931,372	1,083,524	770,054	-29%	-7%
5.2 Ekspres ndërkombëtar	63,387	104,757	119,519	123,551	136,049	154,756	191,894	300,723	675,410	125%	396%
5.3 Totali 5.1+5.2	775,719	784,026	809,229	948,582	961,893	987,761	1,123,266	1,384,247	1,445,464	4%	50%
6 Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	6,732,726	5,151,346	5,455,424	6,019,463	6,147,383	6,667,394	6,660,683	5,896,692	5,582,656	-5%	-9%

Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Në mënyrë të përmblodhur në vijim paraqiten disa nga zhvillimet kryesore në këtë treg:

Posta Shqiptare (Ofrues i Shërbimit Universal)

- ✓ **Shërbim universal postar.** Ky zë në total ka pasur rënie në masën 23 % nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës 2024 dhe rënie me 6% krahasuar me 3 mujorin e mëparshëm T4 2024. Edhe zëri **Postë brenda vendit** ka pasur rënie në masën 24% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm dhe rënie me 5 % krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T4 2024. Ndërsa zëri **Postë Ndërkombëtare** ka pasur një rritje në masën 9% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe një rënie me 22 % krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T4 2024.
- ✓ **Shërbimi Jo universal postar.** Ky zë në total ka pasuar rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 4%, ndërsa në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm T4 2024 ka pasur një rënie me 6%. Në të njëjtat nivele është afërsisht dhe zëri **Postë brenda vendit**. Ndërsa zëri **Postë ndërkombëtare** ka një rritje me 34% nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe rritje me 794% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T4 2024.
- ✓ **Shërbimi Ekspres** Ky zë në total ka pësuar rritje në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë në masën 12% dhe 2% në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm T4 2024. Edhe shërbimi **Ekspres brenda vendit** ka pasur rritje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 10% dhe në masën 2% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T4 2024. Gjithashtu dhe zëri **Ekspres Ndërkombëtar** ka pasur rritje në masën 71% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T4 2024 nuk ka pasur ndrydhim në %.

Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare

- ✓ **Shërbimi Jo Universal Postar.** Ky zë ka një rënie të ndjeshme në 3-mujorin e I 2025 në krahasim me 3-mujorin e 4 të 2024 në masën 50 %, dhe rritje në masën 47% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Edhe zëri **Postë brenda vendit** ka pasur rënie në krahasim me T4 2024 në masën 51% dhe rritje në masën 48% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Zëri **Postë ndërkombëtare** ka pasur rënie në masën 32% në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm T4 2024 ndërsa në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ka pasur një rënie me 15%.
- ✓ **Shërbimi ekspres.** Ky zë ka pasur rritje në totalin e tij krahasuar me 3-mujorin e kaluar T4 2024 në masën 4% dhe rritje në masen 50% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Edhe zëri i shërbimit **Ekspres brenda vendit** ka pasur një rënie në masën 29% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T4 2024 dhe në masën 7% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Për zërin e shërbimit **Ekspres ndërkombëtar** ka pasur rritje në


masën 125% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T4 2024 dhe përkatësisht në masat 396% me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tabela 1.2: Totali i objekteve postare-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T1 2025

Totali i objekteve postare		
	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	4,001,313	72%
<i>Of. e tjerë</i>	1,581,343	28%
Totali	5,582,656	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafiku 1.1: Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, shikojmë rënie në objektet postare në T1_2025 krahasuar me T4 2024 si për Postën Shqiptare ashtu dhe për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare. Krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë kemi një rënie të totalit të objekteve postare për Postën Shqiptare dhe rritje për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.


Tabela 1.3: Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T1_2025

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh.ekspres	Totali
3,784,061	218,853	1,579,742	5,582,656
68%	4%	28%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me 68%, ndjekur nga shërbimi ekspres me 28% dhe shërbimi jo universal me 4%.

Grafiku 1.2: Ecuria në 3-mujor sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar. Nga krahasimi i periudhës T1_2025 me periudhën T4_2024 vërehet që kemi një rënie në masën 5% në volumin total të shërbimeve postare. Në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë evidentohet një rënie në masën 9%.

2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare


Tabela 1.4: Shërbimi Universal Postar T1_2025

Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	3,611,633
Postë ndërkombëtare	172,428
Totali	3,784,061

Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga të dhënat e tabelës 1.4 për T1 2025, për sa i përket shërbimit Universal Postar, vihet re se Posta Shqiptare realizoi gjithsej 3,784,061 objekte, nga të cilat posta brenda vendit zë 95% të objekteve postare dhe posta ndërkombëtare zë 5% të objekteve postare. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 2,759,969 shërbime për objekte të thjeshta dhe 851,664 shërbime për objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 26,424 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 146,004 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 1.3: Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 muaj



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga grafiku i mësipërm shikohet një rënie e shërbimit universal postar në T1_2025 krahasuar me T4_2024 me 6%.

3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare

Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:


Tabela 1.5: Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Sh

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut T1_ 2025	Pjesa tregut T1_ 2024
Shërbim universal postar	3,784,061	94.6%	96.0%
Shërbim jo universal postar	82,974	2.1%	2.0%
Shërbim ekspres	134,278	3.4%	2.0%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare, që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 94.6%, i ndjekur nga shërbimi ekspres me 3.4% dhe nga shërbimi jo universal postar 2.1%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi një rënie të gjitha shërbimeve.

Grafiku 1.4: Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare, ku vihet re një rënie e shërbimit universal dhe e shërbimit jo universal dhe rritje shërbimit ekspres në T1_2025 krahasuar me T4_2024.

4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

Tabela 1.6: Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T1_2025	Pjesë tregu T1_2024
P.Sh	82,974	38%	33%
Of. e tjerë	135,879	62%	67%
Totali	218,853	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafiku 1.5: Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në T1_2025 krahasuar me T4_2024 kanë pësuar rënie në total në masën 40% ku vërehet një rënie prej 6% për Postën Shqiptare, dhe një rënie me 50% për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë T1 2025 përbëhet nga 217,033 objekte brenda vendit dhe 1,820 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.

5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të parë të vitit 2025, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2024, mbi baza tremujore.

Tabela 1.7: Shërbimi ekspres-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për T1_2025

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T1_2025	Pjesë tregu T1_2024
P. Shqiptare	134,278	8%	11%
Of. e tjerë	1,445,464	92%	89%
Totali	1,579,742	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafik 1.6: Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Shërbimi ekspres, gjatë T1_2025 ka pësuar rritje në krahasim me T4_2024 në masën 4% dhe me 46% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndikimin më të madh në këtë rritje e kanë Ofruesit e tjerë.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë së bashku është në vlerën 899,193 objekte postare ose 57% e totalit të këtij shërbimi, ndërsa shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 680,549 objekte postare ose 43% e totalit të këtij shërbimi për periudhën raportuese.

Për sa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri është në vlerën 297,079 objekte dhe sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit është në vlerën 383,470 objekte.